



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.05.2021, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Vahide Imer Gashit, Vjollca Emrush Gashi-Hoxha, Ramiz Faik Gashit, Namon Bahtir Gashit, Zymer Bahtir Gashit, Jakup Faik Gashit, Imer Bahtir Gashit, Ismet Faik Gashit, Skënder Bahtir Gashit, Sadri Sejdi Gashit, Fazli Sejdi Gashit, Selatin Sejdi Gashit, Lumnije Idriz Gashit, Alberina Idriz Gashit, Diamant Idriz Gashit, Arдона Idriz Hysenajt, Gazmend Idriz Gashit, Përparim Idriz Gashit, Arbrora Idriz Gashit, Besnik Idriz Gashit, Burim Emrush Gashit dhe Valon Emrush Gashit.
- II. Prona e paluajtshme komunale, PSH, rrugë, Kuvendi Komunal Prishtinë, që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: parcela kadastrale nr. 2672-28, me sip.742m², Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-02672-28, Zona kadastrale, Prishtinë, me destinim ndërtim, sipas Planit rregullues "Muhaxhirët", i miratuar me Vendimin, nr. 01, nr. 35-1299, dt. 29.06.2010, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim është pjesë e parcelave kadastrale, nr. 01672-1, sip. 259m², Zona kadastrale, Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-01672-1, 01672-4, sip. 1750m², Zona kadastrale Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-01672-4 dhe 01672-5, sip. 2548m², Zona kadastrale Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-01672-5, në pronësi të bashkëpronarëve: Vahide Imer Gashi, Vjollca Emrush Gashi-Hoxha, Ramiz Faik Gashi, Namon Bahtir Gashi, Zymer Bahtir Gashi, Jakup Faik Gashi, Imer Bahtir Gashi, Ismet Faik Gashi, Skender Bahtir Gashi, Sadri Sejdi Gashi, Fazli Sejdi Gashi, Selatin Sejdi Gashi, Lumnije Idriz Gashi, Alberina Idriz Gashi, Diamant Idriz Gashi, Arдона Idriz Hysenajt, Gazmend Idriz Gashi, Përparim Idriz Gashi, Arbrora Idriz Gashi, Besnik Idriz Gashi, Burim Emrush Gashi dhe Valon Emrush Gashi, me destinim rrugë, planifikuar sipas Planit rregullues "Prishtina e re – Zona Qendër", i miratuar me Vendimin nr. 01, nr. 035-186861, dt. 02.10.2013.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues "Muhaxhirët" dhe Planit rregullues "Prishtina e re – Zona Qendër".
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.

- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmben, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastrale të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Arsyetim

Drejtoria e Urbanizmit sipas Vendimit për përcaktimin e kushteve ndërtimore, nr. 05, nr. 350/02-113559/20, dt. 25.01.2021, ka dhënë Pëlqimin për këmbimin e parcelës kadastrale nr.2672-28, sip.742m², ZK Prishtinë, në pronësi të Komunës së Prishtinës, PSH, rrugë, KK Prishtinë, e cila gjendet në kuadër të bllokut urban “b_09” të Planit rregullues “Muhaxhirët”, i miratuar me Vendimin nr. 01, nr. 35-1299, dt. 29.06.2010 dhe pjesët e parcelave: nr. 01672-1, sip.259m², Zona kadastrale, Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-01672-1, 01672-4, sip.1750m², Zona kadastrale, Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-01672-4 dhe 01672-5, sip.2548m², Zona kadastrale, Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-01672-5, në pronësi të bashkëpronarëve: Vahide Imer Gashi, Vjollca Emrush Gashi-Hoxha, Ramiz Faik Gashi, Namon Bahtir Gashi, Zymer Bahtir Gashi, Jakup Faik Gashi, Imer Bahtir Gashi, Ismet Faik Gashi, Skender Bahtir Gashi, Sadri Sejdi Gashi, Fazli Sejdi Gashi, Selatin Sejdi Gashi, Lumnije Idriz Gashi, Alberina Idriz Gashi, Diamant Idriz Gashi, Arдона Idriz Hysenaj, Gazmend Idriz Gashi, Përparim Idriz Gashi, Arbrora Idriz Gashi, Besnik Idriz Gashi, Burim Emrush Gashi dhe Valon Emrush Gashi, me destinim rrugë, planifikuar sipas Planit rregullues “Prishtina e re – Zona Qendër”, i miratuar me Vendimin nr. 01, nr. 035-186861, dt. 02.10.2013.

Propozimi për inicimin e këmbimit të parcelës/ave të tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues “Muhaxhirët”, i miratuar me Vendimin nr. 01nr.35-1299, dt. 29.06.2010 dhe Planit rregullues “Prishtina e re – Zona Qendër”, i miratuar me Vendimin nr. 01, nr. 035-186861, dt. 02.10.2013 dhe Vendimin për caktimin e kushteve ndërtimore, nr. 05, nr. 350/02-113559/20, dt. 25.01.2021. Parcela nr. 2672-28, Zona kadastrale, Prishtinë, shtrihet në zonë të planifikuar për ndërtim të lartë, ndërsa, pjesët e parcelave me nr.1672-1, 1672-4 dhe 1672-5, Zona kadastrale Prishtinë, shtrihen në infrastrukturë publike-rrugë të planifikuar.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019).

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-82502/21, më 12.05.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

